

RAPORT
I Përgjegjësit të grupit të tretë nga Kampi Veror “Ulqini 2009”

Data 21/08/2008 – 01/09/2008



Foto e perbashkët e pjesmarrësve të të dy grupeve (Grupit II dhe III)

Në Kampin aktiv veror “Ulqini 2009” grupi i tretë,ndryshe (grupi i përzier) ,kanë marrë pjesë **50 pjesmarrës**.Struktura e pjesmarrësve, sipas gjinisë,moshes dhe nivelit të aftësisë së kufizuar ka qenë kjo:

1. Pjesmarrës në kamp.....	50
2. Persona me AK.....	38
3. Mëshkuj me AK.....	25
4. Femra me AK.....	24
5. Përdorues të karrocave.....	05
6. Përdorues të kukëzave.....	03
7. Dystrophy moskulate	03
8. Paralizë cerebrale	02
9. Hemipareza të ndryshme.....	10
10. LCC.....	04
11. Me dëmtime në të parë.....	03
12. Me damtime në të degjuar.....	02
13. Me damtime mentale.....	03
14. Me damtime të tjera.....	12
14. Shoqerues.....	08
15. Staf.....	03
Totali	50

• **Stafi udhëheqës i grupit :**

- 1. Behxhet Binaku,përgjegjës grupi**
- 2. Jakup Vita Logjistikë**
- 3. Arbneshja Krasniqi, teknike shendetësore**

Stafi udhëheqës i grupi të tretë në bashkëpunim me stafin e grupit të dytë në tërësi kanë implementuar programin e aktiviteteve të hartuar para nisjes për në kamp dhe mund të konstatohet se në përgjithësi,aktivitetet e parapara kanë qenë të realizuara sipas dinamikës së programit.

Bazuar në atë se kësaj here të dy grupet(grupi i dytë dhe ai i tretë)kanë marrë pjesë në kamp në të njëjtën kohë,kordinimi dhe bashkëpunimi i stafeve të të dy grupeve ka qenë i përbashkët dhe në përgjithësi menagjimi i të dy grupeve ka qenë i udhëhequr nga një qendër komanduese,përfshirë disa aktivitetet të cilat për shkak të rrethanave objektive janë zhvilluar ndaras.



Stafi o kampit

- **Transporti:**



Transporti I pjesmarrësve të kampit nga Prishtina për në Ulqin dhe anasjelltas është bërë më autobus të Komanisë transportuese – Arbeni Tours nga Ferizaj .Arritja e autobusve në pikën e nisjes ka qenë me kohë e gjithashtu edhe starti i nisjes ka qenë në orën e paraparë 20,00.Gjatë udhëtimit për në Ulqin si dhe kthimit në Prishtinë nuk ka pasur ndonjë problem që vlenë të theksohet,përjashtu mungesën e pushimeve të nevojshme gjatë rrugës për në Ulqin nga vozitësit,gjë që ka pasur edhe ankesa nga pjesmarrësit për ndalesa të pakta të autobusve.Kjo situatë është përimisuar me rastin e kthimit nga Ulqini,ku ka pasur gjithsejt tri ndalesa gjatë rruges të autobusve.

- **Prezentimi i aktiviteteteve (Dita e parë data 22 gusht 2009)**

Në mbrëmjen e ditës së parë,z.Agron Zeneli menagjer i përgjithshëm i Kampit , së bashku me stafin udhëheqës i ka informuar pjesmarrësit shkurtimisht mbi historikun e Handikos-it , Organizatën Joqeveritare Onlus Bazzoni,si donator i këtijë kampi,si dhe mbi rregullat dhe aktivitetet të cilat do të pasojnë në vazhdim gjatë këtyre 10 ditëve në kamp.



Pjesmarrësit duke u informuar mbi aktivitetet e kampit

- **Aktivitetet fizikale (Gjymnastika e mengjesit)**
- 9,00 – 10,00

Pjesë e rëndësishme e planit të aktiviteteve është avansimi dhe mirmbajtja e gjendjes fizike të pjesmarrësve. Gjymnastika e mengjesit e cila është aplikuar për qdo mengjes, është zbërthyer në vete me aktivitetet të llojllojshme fizike, si: (nxemja e muskujve të gjymtyrëve të epërme dhe të poshtme të trupit, stimulimi i muskujve të gjymtyrëve, lëvizjet e nyjeve të gishtave të dorës, brrylave të duarvë dhe të këmbëve, nyjeve të qafës, belit dhe pjesëve tjera të trupit.



Gjymnastika e mengjesit ,dita e parë (njohja me njeri tjetrin) dhe meditimi

Duke ditur se struktura e pjesmarrësve të grupit të tretë sa i përket niveleve të aftësisë së kufizuar ka qenë shumë heterogjene edhe aktivitetet fizikale kanë qenë të llojeve të ndryshme. Dinamikës së aktivitetetve fizikale të mengjesit I është përmbajtur mbi 95 % e pjesmarrësve, përjashtu disa raste të cilët e kanë pas edhe të ndaluar të nënshtrohen këtyre aktiviteteve.

Një pjesë e aktiviteteve fizikale të gjymnastikës së mengjesit janë zhvilluar në fushën sportive pranë hotelit, ndërsa një pjesë tjetër në plazhin buzë detit.



Gjymnastika e mengjesit e zhvilluar në fushën e sportive pranë Hotelit Belevi



Zhvillimi i garave ne hudhjen e rathëve dhe topave në bar

- **Plazhi 11,00 -17,00**

Duke ditur se një numër i madhë i pjesmarrësve janë ballafaquar për herë të parë me ujin e detit dhe nuk kanë pasur njohuri mbi notin, është aplikuar sistemi i futjes në ujë me percjelles dhe janë demonstruar njohuri themelore të mësimit të notimit. Gjithashtu për qdo ditë është aplikuar edhe futja në ujë të personave që nuk kanë mundur të lëvizin dhe u është mundësuar assistim i deshiruar në ujë nga stafi i grupit dhe pjesmarrësve tjerë vullnetar



Të mësuarit e notit për ata që deri më tani nuk kanë ditë të notojnë



Aktivitetet i perbashket i zhvilluar ne ujë



Loja e perbashket të gjithë në ujë

Vlenë të theksohet se gjatë gjithë kohës, të gjithë pjesmarrësit, në menyrë të organizuar dhe masovikisht kanë qenë pjesë përbërëse e të gjitha aktiviteteve sportive dhe kulturore që janë organizuar në kamp.

- **Aktivitetet Sportive rekreative: 17,30 – 19,00**

Për qdo ditë e sidomos në orët e pasditës janë aplikuar aktivitete sportive – rekreative si psh :zhvillimi i garave në disiplinën e ping – pongut atë në pikado,si dhe aktivitetet tjera kulturore muzikore.



Garat ne pingpongut



Ggarave ne pikado



Garat ne Shah



Me i miri ne Turnirin e Sgahut

- **Seancat e Hapura – 20,00 – 21,00 (Behxheti)**

Gjatë orëve të mbrëmjes sipas planit kemi aplikuar edhe seancat të hapura më pjesmarrës,ku janë trajtuar tema të ndryshme të lidhura më interesin dhe jetën e personave me aftësi të kufizuar.Janë trajtuar këto tema

- Aftësia e kufizuar si qështje e të drejtave të njeriut?
- **Qasja e shoqërisë ndaj PAK-ve nëpër etapa historike,sipas 4 modeleve:**
- **1.Modeli shendetësor**
- **2.Modeli mëshirues**
- **3.Modeli Social**
- **4.Modeli i bazuar në të drejta**
- **Ç`ka është aftësia e kufizuar?**
- **Vlerat bazuar sipas të drejtave të njeriut**
- **Parimet kyqe të të drejtave të njeriut**
- **Dokumentët ndërkombëtare mbi te drejtat e njeriut**
- **Zingjiri i pandërprerë i levizës mbi barazimin e mundësive**
- **Definicionet e Diskriminimit**
- **Mjetet kundër diskriminimit etj**

Është më rëndësi të theksohet se interesimi i pjesmarrësve ka qenë shumë i lartë dhe pjesmarrja e tyre ka qenë shumë aktive.



Pjesmarrës duke ndjekur Temen "Aftësia e kufizuar si qështje e të drejtave të njeriut"

Plazhi

Pjesmarrësit dukë bërë plazh



Aktivitetet Kulturore

Gjatë kohës sa ka zgjatur kampi, është, organizuar edhe mbremjë e përbashkëte të dy grupeve "PARTY". Rrjedha e mbrëmjes ka qenë e përshkuar me aktivitete të larmishme, muzikë, valle, si dhe ky rast solemn është shfrytëzuar për shpalljen e më të mirëve në garat e zhvilluara në turnirin e shahut, pingpongut, pikados, si dhe në këtë rast solemt janë shpërblyer qifti më simpatik bashkëshortor i kampit, stafi më i angazhuar nga radhet e dy motrave medicinale dhe mjekës së kampit.

Mbrëmja "PARTY"




Të gjithë në vallë pa dallim

- **Dalja në Qytet**

Pjesë e aktiviteteteve të kampit ka qenë edhe dalja e pjesmarrësve në Qytetin e bukur të Ulqinit. Shetia në qytet ka qenë e organizuar shumë mirë, ku secili pjesmarrës ka pasur mundësi që gjatë qëndrimit në kamp të dalë në qytet. Dalja në qytet ka qenë e organizuar në menyre grupore dhe është bërë me automjetin e Handikos-it.

- **Kujdesi shendetësor:** Gjatë qëndrimit në kamp, marrë në përgjithësi, nuk kemi pasur probleme serioze shendetësore, përjashtuar disa intervine të vogla. Duhët theksuar se stafi mjekësor i përberë nga dy motrat medicinale dhe doktoresha e kampit, kanë merita të jashtëzakonshme për angazhimin maksimal në ofrimin e shërbimeve mjekësore për të gjithën pjesmarrësit që kanë kërkuar ndihmë. Në përgjithësi gjendja shendetësore e pjesmarrësve ka qenë solide dhe pa probleme.



Pjesmarrës nga Shoqata e të Verbërve



Pjesmarrës nga Klubi "Dëshira" të Kosovës



Pjesmarrës nga Shoqata e të Shurdhërve e Kosovës



Foto e pjesmarrësve në kamp nga grupi i tretë

- **Përshtypjet e pjesmarrësve:** Në ditën e fundit të përfundimit të kampit stafi i kampit, sejcilit pjesmarrës i ka ufruar nga një pytësore vlerësues për përshkrimin e përshtypjeve nga Kampi. Nga të gjithë pjesmarrësit fjalët më të shpeshta kanë qenë si:

- Falemnderime për veprën madhore dhe sakrificën e dy engjujeve tashmë martirë të rënë për humanizëm z. Antonio Sircana dhe Roberto Bazzoni.
- Falemnderime për familjen Bazzoni dhe Organizatën Onlus Bazzoni
- Falemnderime për veprën e z. Halit Ferizit, presidentit historik të HandiKOS-it tashmë të ndjerë
- Falemnderime për OJQ "HandiKOS"
- Falemnderime për stafin e kampit

Nga përshtypjet e pjesmarrësve, po shkëpus disa vargje të një personi të cilat pasqyrojnë ndjenjat dhe respektin për familjen Bazzoni:

Pushimet e mija në Ulqin Po afroreshin ditët e fundit të verës dhe unë po mendoja për pushimet verore, dëshira ime është që të shkoj me kolektivin tim të dashur, ku mund të them se për mua është shtëpia ime e dytë ku pjesën më të madhe të ditës dhe të jetës sime e kaloj në Handikos. Po erdhi edhe ai moment kur një megjës deri sa isha duke i kryer disa punë në Handikos, më thanë se më kanë zgjedhur për të shkuar në Ulqin, që për mua ishte një befasi e papritur, dhe të them të verteten nuk e kam pritur. OK tash po përgaditem psikikisht për udhëtim, se e kam pasur pak vështirësi se nuk jam larguar asnjehere vetë nga shtëpia. Mirepo dëshira e madhe dhe vullneti i madh për të kaluar një pushim të këndshëm, i larguan brengat e mia, dhe u përgadita psikikisht dhe fizikisht. Derisa po pritnim autobusin të gjithë ishim kureshtarë dhe njëkohësisht të lumtur si do të kalonim, si do të jete udhëtimi, si do të ishte vendi ku do të vendosemi e kështu me radhe... RRuges kemi kaluar shumë mire, jemi ndalur edhe në disa vende për të pushuar, atmosfera ishte e ngrohtë, dhe në fytyrat e secilit shihet një gezim i papershkruar. Në Ulqin mbërritem kah ora 9. ishte një mëngjes i freskët dhe i këndshëm edhe pse ishim të lodhur pak nga rruga prap se prap u këndelëm, dhe ngadale filluam që të shkonim në hotelin..... ku një koridor i madh të qonte neper salla të ndryshme, recepcionistët ishin shumë të sjellshëm, na pritën shumë mire, mandej u vendosem në dhoma të cilat ishin të rregulluar

a bukur, pastër e bëmë një pushim të mire. Mandej shkuam në restorant për drekë ku ushqimi ishte shumë i mire, dhe i shijshëm, (kishte mundësi me zgjedhe qka të duash). Të gjithë u përgaditem për plazh dhe u nisem, secili e kishim shtratin në të cilin shtriheshim dhe rrezitëhim, dhe kenaqëhim me bukuri të plazhës së Ulqinit qindvjaqare. Përveq ushqimit, gjumit, plazhës që ishim shumë të kenaqur me keto sherbime në kishim edhe



aktivitete të lira, të cilat na jepnin me shumë kondicion, gjatë levizjeve tona me karroca. Edhe qka ka qenë një befasi shumë e këndshme për neve, ka qenë mbremja

gazmore,ku ka qene nje atmosfere tejet e ngrohte me plot humor dhe me plot kenaqesi,ku kane vallezuar,kenduar,..Jam kenaqur shume,nuk kam shprehje me fjale per ta pershkruar ate ndjenje,e ma merr mendja qe edhe koleget e mi jane ndier ashtu si une.Ndejtem plot 11 dite, me besoni me jane dukur si 5 dite,aq mire qe ka qene,erdhi edhe dita per tu ndare nga Ulqini i bukur,ma merr mendja qe do te shkojme prap dhe perseri do te kaloj ne te njejtat perjetime te kendshme dhe te paharruara,si ne endrrat perrallore.E per fund mund te them te gjitha keto kenaqesi pa ndihmen e Handikosit dhe te donatorit,nuk do ti kishim pasur,ju falenderoj nga shpirti dhe zemra,dhe Zoti ju bekoftë qe keni menduar dhe ju keni ofruar kete ndihme personave me aftesi te kufizuar.

THANK YOU Mr.BAZZONI